



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:159790  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05426728

**AA.nr.360/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi e Hajriz Hoti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses F.M - Gjilan, përfaqësuar me autorizim nga avokat Halit Azemi nga Gjilani, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1910/2022, të datës 28.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditëses F.M- Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1910/2022, i datës 28.04.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1910/2022, të datës 28.04.2023, është refuzuar kërkesëpadia e paditëses F.M, Gjilan, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr. 4935/21 datë 06.12.2021 dhe vendimi nr.38/2022 datë 10.05.2022 dhe të urdhërohet e paditura që paditësen ta regjistroj në librin e shtetësisë të Republikës së Kosovës dhe atë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, si e pa bazuar .

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, H.A avokat nga Gjilani, për shkak të: shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të priset, dhe lënda të kthehet në rivendosje apo të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Komisioni për Ankesa dhe për Shtetësi, me vendimin nr.38/2022 të datës 10.05.2022 në pikën 1 të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën nr.38/2022 të datës 10.05.2022 për refuzimin e kërkesës për natyralizimin e bashkëshortit e parashtruar nga parashtruesja e ankesës F.M e lindur ma datë, ... në Serbisë, kundër vendimit me referencën e dosjes Nr.4935/21 të datës 06.12.2021 i cili është nxjerr nga Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migrim me datën 29.10.2021.Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur qe te mbetet ne fuqi vendimi me nr.4935/21 i datës 06.12.2021 i cili është e nxjerr nga Departamenti për shtetësi Azil dhe Migrim me date 21.10.2021.

Paditësja e pa kënaqur me vendimet e lartcekura të të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 03.08.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tyre, me propozim që të njëjtit të anulohen si të kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimeve të lartcekura, të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me neni 9 dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë vëren se paditësja nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, si dhe neni 11 paragraf 2 nën paragrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ 05/2020,për Procedura të Fitimit të Shtetësisë ne Republikën e Kosovës, kjo për faktin se nuk ka arritur të dëshmoi posedimin e leje qëndrimit të vazhdueshëm si dhe leje qëndrimet tjera nuk janë dëshmuar si të vazhduara në mënyrën e përcaktuar, dokumentet e dorëzuara me padi janë kopje të njëjta nuk janë të vërtetuar apo me vulë përkatëse, nuk është dorëzuar dëshmia se e njëjta nuk është nën hetim nga shteti i origjinë, po ashtu nuk janë dorëzuar dëshmi për posedimin e mjeteve monetare për të siguruar jetesën e vet dhe të personave për mbajtjen e të cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skemat social, kushtet të cilat kërkohen sipas dispozitave të nenit 10 dhe 11 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të UA 05/2020 dhe plotësim e të cilave kushte paditësja nuk ka arratisur ta dëshmoj me prova konkrete. Andaj paditësja para gjykatës së shkallës së parë nuk ka ofruar prova me të cilat do të dëshmonte pretendimet e saj, kurse ato të bashkangjitura në shkresat e lëndës nuk ishin të mjaftueshme për të pasur një vendim ndryshe se vendimi në dispozitiv të këtij vendimi. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe pretendimet e paditëses si në padi se i plotëson të gjitha kushtet ligjore për fitimin e shtetësisë por se këto pretendim gjykata e shkallës së parë nuk i pranoi si të bazuara sepse nuk janë mbështetur me prova konkrete. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë vlerësoi se vendimi kontestues i të paditurës, është i drejtë dhe bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të saj.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se duke pasur parasysh dokumentacionin relevant që gjindet në shkresat e lëndës shihet se paditësja jeton në Gjilan ku edhe e ka vendbanimin, jeton nga dita e martesës me 29.05.2017 tani ka 6 vite që është martuar dhe jeton me bashkëshortin e vet F..., ashtu që në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shtetësinë parashihet afati tre vjeçar të ketë lidhje martesore, ajo tani ka 6 vite dhe ka leje të vlefshme qëndrimi ashtu që i plotëson kriteret për shtetësi me natyralizim të bashkëshortit. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoj, ngase vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses në padi janë të pa bazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimet e organit administrativ janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Sepse paditësja nuk ka arritur të dëshmojë se i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me dispozitat e nenit Me nenin 10 të Ligjit nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës përcaktohet: *“1. Personi i huaj e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me kërkesë të tij nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës plotëson kushtet vijuese: 4 1.1. është i moshës madhore; 1.2. nëse ka qëndruar pa ndërprerë për pesë (5) vjet në Republikën e Kosovës pas marrjes së leje qëndrimit të përhershëm; 1.3. deklarohet dhe me sjelljen e tij gjatë qëndrimit në Republikën e Kosovës ka dëshmuar se pranon rendin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës dhe se është i integruar në shoqërinë kosovare përmes lidhjeve sociale, kulturore, shkencore, ekonomike ose profesionale. Kriteret do të përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme; 1.4. posedon mjete materiale të mjaftueshme për të siguruar jetesën e vet dhe të personave për mbajtjen e të cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skemat e asistencës sociale; 1.5. i ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit; dhe 1.6. ai/ ajo dëshmon njohuri elementare në njërën prej gjuhëve zyrtare në shkrim dhe lexim të Republikës së Kosovës, kulturën dhe rregullimin shoqëror;”* Me nenin 11 të Ligjit nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës përcaktohet: *“ 1. Personi i huaj i cili është bashkëshort i shtetasit të Republikës së Kosovës e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës në bazë të kërkesës, nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës plotëson kushtet vijuese: 1.1. të paktën tre (3) vite ka lidhje martesore me shtetasin e Republikës së Kosovës; 1.2. është duke jetuar rregullisht në Republikën e Kosovës për të paktën një (1) vit dhe posedon leje qëndrim të përkohshëm të lëshuar nga organi kompetent. 1.3. dispozitat nga nënparagrafët 1.1, 1.3 ,1.4 dhe 1.6 të paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligji vlejnë po ashtu edhe për natyralizimin e bashkëshortit”*. Po ashtu me nenin 11 paragraf 2 nën-paragrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ 05/2020 për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë

së Republikë së Kosovës përcaktohet: “ 2.2. dëshmi për leje qëndrim të përkohshëm dhe të vazhdueshëm së paku një (1) vit para parashtrimit të kërkesës”. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i’u ka referuar nenit 7 paragrafit 1 të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së me të cilin përcaktohet se: ‘ Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla’.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të kontestuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.360/2023, me datë 14.02.2024

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi